




STUDIO "AUDIT 411"

Bulevardi "Gjergj Fishta" Rruga "Nikolla Jorgo"
Ndërtesa8, Hyrja I, Ap. 10, Tirane



NIPT: L91310004V

Telefon: +355 4 242 8214,

Mobile: +355 69 20 73030

E-mail: ilir.daiu@kontabiliteti411.com

RAPORT

MBI RRITJEN E KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË SHOQËRISË "EUROPA" SH.P.K Elbasan

Unë, Eksperti Kontabël i Autorizuar, Ilir Daiu, i ngarkuar nga ortakët e shoqërisë "EUROPA" shpk, Elbasan, për verifikimin dhe vërtetimin e shtesës së kapitalit të shoqërisë së mësipërme, në përputhje me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe statutin e shoqërisë paraqes raportin tim si më poshtë vijon:

Shoqëria "EUROPA" sh.p.k, Elbasan, është themeluar me Vendim Gjykate të Tiranës Nr.8622 në Datë 23-01-1995 si person juridik me veprimtarë kryesore "Projektim prodhim zbatim dhe rikonstrukcion te godinave industriale dhe civile, urave me konstruksione metalike, mbikalime per kalimtare dhe hekurudhore, Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime hidroteknike, sisteme hidraulike dhe impiante per bonifikeme, diga damba, struktura metalike per tunele, sillosa metalike, kulla uji metalike. Prodhime dhe montime per n/stacione elektrike, linja tensioni te larte dhe shperndarjen e energjise. Ndertim impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri dhe mirmbajtjen e tyre, Impjante ngritese e transportuese (vinça te te gjithë llojeve, anshesore, shkelle levizese, transportues ne pergjethsi). Prodhim montim parafabrikate struktura dhe konstruksione metalike. Impjante teknologjike termike dhe kondicionimi. Ndermarje montimi per vete dhe per llogari te te treteve ne kryerjen e veprimtarive industriale bujqesore, etj. Tregtim me shumice dhe me pakice te te gjitha mallrave industriale e ndertimore. Tregtim me shumice dhe pakice te makinerive dhe paisjeve te te gjitha llojeve perfshire dhe vegla pune, paisje sinjalizimi, kondicionere, ventilatore, paisje ventiluese, ngrohësa diellore etj. Konstruksione dhe panele te gatshem dhe gjysem te gatshem ndertimore, impjante gazi ashensore shkalle te levizshme. Transport mallrash per vete dhe te trete banda dhe jashte territorit shqiptare, Import- Eksport sipas legjislacionit Shqiptar." Selia e shoqërisë është në Elbasan Bradashesh Ish K. Metalurgjik.



Kapitali i nënshkruar i saj, para se të bëhet kjo rritje, është 371'000'000 lekë.

Ortaku Thanas RULA, zotëron 50 përqind të kapitalit.

Ortaku Vangjel RULA, zotëron 50 përqind të kapitalit.

Për sa më sipër është bërë rregjistrimi në Regjistrin Tregtar.

Për kryerjen e misionit që m'u ngarkua nga ortakët, për vërtetimin e shtesës së kapitalit të nënshkruar të shoqërisë "EUROPA" shpk, Elbasan, unë kam vepruar në përputhje me SKK, me SNA, me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare dhe statutin e shoqërisë si dhe në përputhje me normat e kodit të etikës të profesionistit kontabël.

Unë, gjithashtu, jam mbështetur në dokumentat e mëposhtme:

-Pasqyrat Financiare të shoqërisë deri në fund të vitit 2019.

-Raportet e auditimit të këtyre Pasqyrave Financiare.

-Në dokumentat ligjore të shoqërisë.

-Në vendimet e ortakëve për pakësime dhe shtesat e kapitalit të shoqërisë.

-Në inventarët e aktiveve të shoqërisë në fund të vitit 2019.

Nga shqyrtimi i dokumentave kontabël dhe inventarëve të fund vitit 2019, rezulton se pasqyrimi i pasurisë së shoqërisë në Pasqyrat Financiare dhe vlerësimi i saj është bërë sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (ndryshuar me ligjin nr. 9477 date 09.02.2006).

Aktualisht, në bilancin e mbyllur më datë 31/12/2019, shoqëria "EUROPA" shpk, ka rezultuar me fitimin e vitit financiar 2019 në masën 59 '563' 800 lekë për të cilët, ortakët kanë vendosur të shtojnë 59'500'000 lekë në kapital dhe krijimin e rezervës ligjore referuar pikës 2.b të Vendimit nr.1 datë 30.06.2020 prej 63' 000 lekë.

Konkretisht, në bilancin e mbyllur më 31/12/2019, shoqëria ka paraqitur në zërin e kapitaleve të veta, përveç kapitalit aksionar që është 371'000'000 lekë; dhe rezerva ligjore të krijuara 11'239'963 lekë si edhe fitimin e vitit financiar 2019 prej 59' 563'800 lekë. Gjithsej kapitalet e veta 441'803'763 lekë.

Mbështetur në vendimin e ortakëve Nr.1 datë 30.06.2020 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë dhe pas verifikimit nga ana ime të llogarive kontabël të kapitaleve të veta dhe të tepricave të tyre të paraqitura në bilancin e mbyllur më datë 31.12.2019 kapitali i shoqërisë do të zmadhohet duke përfshirë sa më poshtë:

- Nga fitimi i vitit financiar 2019 gjithsej 59' 563'800 lekë do të kalojnë për rritjen e kapitalit 59'500'000 lekë dhe për rritjen e Rezervave ligjore në masën 63'800 lekë.



Kështu, kapitali i nënshkruar i shoqërisë "EUROPA" shpk, Elbasan nga 371' 000' 000 lekë që ishte para rritjes duke i shtuar vlerën 59'500'000 lekë do të **bëhet 430'500'000 lekë.**

Rezerva Ligjore e Shoqërisë "EUROPA" shpk, Elbasan nga 11'239 '963 lekë do të **bëhet 11'300 '763 Lekë.**

Kapitali i nënshkruar ndahet në 2 **(dy) kuota** me vlere nominale **215'250'000 lekë/Kuota.**

Pjesmarrja në kapital nuk ndryshon. Ai zotërohet 1 Kuotë nga Vangjel Rula dhe 1 Kuotë nga Thanas RULA .

Si PËRFUNDIM Unë vlerësoj se:

- **Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "EUROPA" sh.p.k Elbasan, rritet me vlerën 59'500'000 lekë.**
Mbas rritjes së mësipërme kapitali i nënshkruar bëhet 430'500'000 lekë , i cili zotërohet 50 përqind nga Z. Vangjel RULA dhe 50 përqind nga Z. Thanas RULA .
- **Rezerva Ligjore e Shoqërisë "EUROPA" shpk, Elbasan rritet me vlerën 63'800 lekë .**
Mbas rritjes së mësipërme Rezervat Ligjore bëhet 11'300 '763 Lekë.

**AUDITUES I PAVARUAR
ILIR DAIU**

Datë 24/07/2020

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Rruga "Nikolla Jorgo", Ndërtesa8,
Hyrja 1, Ap. 10, Tirane

Mobile: +355 69 20 73030

E-mail: ilir.daiu@dk-audit.com

Nr. Liçencës 361

